

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 331, Datë 18.12.2025

MBI

**VLERËSIMIN E RAPORTIT VJETOR TË ZYRTARIT TË PAJTUESHMËRISË SË
SHOQËRISË “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG”, DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ,
PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PAJTUESHMËRISË RREGULLATORE
PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 16 dhe 47, pika 5 gërma “b” të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror” të ndryshuar; vendimit nr. 149, datë 10.09.2020 të bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), “Mbi miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore/Regulatory Compliance Programme” Paraqitur nga TAP AG në bazë të “Opinionit të Përbashkët Përfundimtar/Final Joint Opinion” në kuadër të procedurës së përjashtimit për gazsjellësin TAP”; vendimit të bordit të ERE-s nr. 105, datë 29.06.2020, të ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, “Mbi miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) së TAP dhe Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë”, si dhe në zbatim të Direktivës 2009/73/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009, “Mbi rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror dhe për shfuqizimin e Direktivës 2003/55/EC”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.12.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Pajtuësshmërisë dhe Vlerësimit të Impaktit Rregullator, me nr. 3085 prot., datë 17.12.2025, “Mbi analizën dhe vlerësimin e Raportit Vjetor të Pajtuësshmërisë Rregullatore për vitin 2024 të “TRANS ADRIATIC PIPELINE AG”, degë e shoqërisë së huaj”,

Konstatohet se:

1. Parashtrimi dhe shqyrtimi i Raportit Vjetor të Pajtuësshmërisë për vitin 2024

- Në zbatim të nenit 47, pikat 5 gërma “b”, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar, si dhe të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 149, datë 10.09.2020, “Mbi miratimin e “Programit të Përputhshmërisë Rregullatore, dhe vendimit nr. 105, datë 29.06.2020, të ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, “Mbi miratimin e Zyrtarit të Përputhshmërisë (ZP) së TAP dhe Kontratës për Ofrimin e Shërbimeve të Zyrtarit të Përputhshmërisë”, Zyrtari i Përputhshmërisë është ngarkuar të paraqesë çdo vit pranë ERE një raport mbi monitorimin dhe zbatimin e programit përkatës.
- ERE, në ushtrim të kompetencave të saj mbikëqyrëse, vlerëson raportimin e paraqitur nga Zyrtari i Pajtuësshmërisë, si pjesë e garantimit të pavarësisë funksionale, transparencës dhe trajtimit jo-diskriminues në tregun e gazit natyror.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 149, datë 10.09.2020, ka miratuar “Programin e Pajtuësshmërisë Rregullatore” të shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG”, degë e shoqërisë së

huaj, ndërsa me vendimin nr. 105, datë 29.06.2020, ndryshuar me vendimin nr. 150, datë 10.09.2020, ka miratuar Zyrtarin e Pajtueshmërisë së TAP AG dhe Kontratën për Ofrimin e Shërbimeve të tij.

2. Dorëzimi dhe shqyrtimi i raportit për vitin 2024

- Në zbatim të detyrimeve të Programit të Pajtueshmërisë, më datë 28.03.2025, Zyrtari i Pajtueshmërisë i TAP ka depozituar pranë ERE-s Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë për vitin 2024, në version konfidencial dhe jokonfidencial, në gjuhën shqipe dhe angleze, në përputhje me afatet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën 3.1.1.1(g) të Programit të Pajtueshmërisë.
- ERE ka kryer vlerësimin dhe analizën e këtij raporti, duke e konsideruar atë si dokument zyrtar që synon të informojë autoritetet rregullatore mbi masat e marra për zbatimin e detyrimeve të Programit të Pajtueshmërisë dhe çdo rast të mundshëm shkeljeje.
- Bordi i ERE-s, në mbledhjen nr. 36, datë 09.09.2025, në vijim të vlerësimit të raportimit, ka kërkuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë informacion plotësues lidhur me: zbatimin e kërkesës për publikimin e versionit jokonfidencial të raportit në faqen zyrtare të TAP-it, në funksion të parimit të transparencës, referuar Programit (pika 3, gërma “g”) dhe kërkesave të Direktivës së Gazit; mënyrën e administrimit të njoftimeve për shkelje të dyshuara/shqetësime (“speak up”), sipas pikës 5 të Programit, përfshirë funksionalitetin dhe publikimin e adresës së dedikuar regulatorycompliance@tap-ag.com.
- Në përmbushje të kërkesave të mësipërme, Zyrtari i Pajtueshmërisë TAP, me shkresën REF NR. LT-TAP-ERE-00061, datë 10.10.2025, me lëndë: “Përgjigja e TAP-it për pyetjet e ngritura nga ERE lidhur me Raportin Vjetor të Pajtueshmërisë Rregullatore të TAP-it”, ka depozituar përgjigje dhe sqarime në gjuhën shqipe dhe angleze.

3. Përmbushja e detyrimeve nga Zyrtari i Pajtueshmërisë për vitin 2024

- Nga analiza e dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimet e kryera rezulton se Raporti Vjetor i Pajtueshmërisë për vitin 2024 është përgatitur dhe depozituar në përputhje me kërkesat e Programit të Pajtueshmërisë Rregullatore dhe kuadrin ligjor/rregullator në fuqi.
- Lidhur me çështjen e publikimit të versionit jokonfidencial, është sqaruar se, sipas pikës 3.1.1.1(g) të Programit, publikimi i variantit jokonfidencial realizohet vetëm nëse kërkohet nga legjislacioni kombëtar në fuqi, ndërkohë që raportimi dorëzohet rregullisht pranë autoriteteve rregullatore brenda afateve vjetore. Në këtë kuadër, ERE vlerëson se raporti i monitorimit mbi zbatueshmërinë e Programit trajtohet me status konfidencial dhe mund të publikohet vetëm nëse dhe në masën që kjo kërkohet nga legjislacioni/rregulloret përkatëse në fuqi.
- Është konstatuar se gjatë vitit 2024 nuk janë raportuar dhe nuk janë evidentuar raste shkeljeje të statusit ITO, apo të parimeve të ndarjes funksionale, trajtimit të barabartë dhe jo-diskriminues, dhe të mbrojtjes së informacionit të ndjeshëm tregtar.
- Programi i Pajtueshmërisë Rregullatore i TAP AG është i publikuar në faqen zyrtare të TAP dhe, në përputhje me parashikimet e pikës 5 të tij, përfshin edhe mekanizmat e raportimit “speak up”, si dhe adresën elektronike të dedikuar regulatorycompliance@tap-ag.com, e cila shërben si kanal komunikimi për raportime/shqetësime lidhur me pajtueshmërinë rregullatore.
- Raportimi dhe dokumentacioni plotësues i paraqitur nga Zyrtari i Pajtueshmërisë, sipas kërkesës së TAP, trajtohet si informacion konfidencial, në përputhje me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 65, datë 26.03.2018, “Për mbrojtjen e informacionit konfidencial”, dhe, nëse kërkohet, TAP shprehet i gatshëm të hartojë një variant jokonfidencial të dokumentacionit.

4. Nevoja për përmirësim dhe rekomandime për periudhën pasardhëse

- Vlerësohet se Zyrtari i Pajtueshmërisë i TAP AG ka përmbushur në mënyrë të rregullt dhe të plotë detyrimet e tij për vitin 2024, duke siguruar raportim vjetor pranë autoriteteve rregullatore dhe duke kontribuar në garantimin e pavarësisë funksionale, transparencës dhe trajtimit jo-diskriminues në tregun e gazit natyror.
- Zbatimi i Programit të Pajtueshmërisë Rregullatore vlerësohet në përputhje me kërkesat e legjislacionit kombëtar, Direktivës 2009/73/EC, dhe akteve rregullatore në fuqi, ndërkohë që për periudhën pasardhëse mbetet e rëndësishme të sigurohet vazhdimësia e masave të transparencës, funksionaliteti i kanaleve të raportimit të brendshëm dhe administrimi i informacionit konfidencial sipas standardeve rregullatore.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Miratimin e Raporti Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë së shoqërisë “Trans Adriatic Pipeline AG”, degë e shoqërisë së huaj, për vitin 2024.
2. Miratimin e Vlerësimeve të ERE-s për vitin 2024, mbi Raportin Vjetor të Zyrtarit të Pajtueshmërisë. (Bashkëlidhur)
3. Drejtoria e Pajtueshmërisë dhe Impaktit Rregullator, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Trans Adriatic Pipeline AG”, Zyrtarin e Pajtueshmërisë dhe Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

Mbi vlerësimin e raportit të Zyrtarit të Pajtueshmërisë TAP-it për vitin 2024

Enti Rregullator i Energjisë (ERE), në cilësinë e autoritetit rregullator të pavarur për sektorin e energjisë elektrike dhe gazit natyror në Republikën e Shqipërisë, mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe në vendimet përkatëse të Bordit të ERE-s, ushtron funksionin mbikëqyrës dhe vlerësues mbi zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë nga operatorët. Në këtë kuadër, një prej instrumenteve thelbësore është shqyrtimi dhe vlerësimi i raportit vjetor të hartuar nga Zyrtari i Pajtueshmërisë, i cili paraqet një raport të zbatimit të programit dhe masat e ndërmarra për të garantuar ndarjen funksionale, ligjore si dhe për të promovuar transparencën, paanshmërinë dhe funksionimin jo-diskriminues të operatorit në treg. Për këtë raportim, vlerësojmë se operatori ka patur një performancë pozitive dhe se Zyrtari i Pajtueshmërisë ka përmbushur përgjithësisht në mënyrë cilësore detyrimet e tij ligjore dhe funksionale në zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë për vitin 2024

Bordi i ERE -s vlerëson për vitin 2024:

1. *Përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe institucionale për dorëzimin e Raportit Vjetor 2024* në versionet konfidencial dhe jokonfidencial, në dy gjuhë. Raportimi përmban masat për zbatimin e Programit të Pajtueshmërisë dhe vlerësohet në përputhje me standardet dhe rregulloret në fuqi. Raporti i monitorimit mbi zbatueshmërinë e programit vlerësohet me status konfidencial dhe mund të publikohet nëse dhe në masën që kërkohej nga legjislacioni dhe rregulloret përkatëse në fuqi në çdo kohë.
2. *Zbatimi dhe monitorimi i Programit të Pajtueshmërisë Rregullatore*. Në bazë të raportimit, konstatohet se veprimet dhe proceset e zbatuara nga TAP AG janë në përputhje me Programin e Pajtueshmërisë të miratuar nga ERE me vendimin e Bordit nr. 149, datë 10.09.2020. Programi është publikuar në faqen zyrtare të TAP-it, duke siguruar transparencë dhe mundësi verifikimi për palët e interesuara mbi respektimin e kërkesave ligjore nga kompania.
3. *Pjesëmarrja dhe informimi i Bordit*. Vlerësohet se Zyrtari i Pajtueshmërisë ka marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e TAP-it dhe ka ofruar 12 përditësime për strukturat e Bordit, duke siguruar mbikëqyrje të vazhdueshme dhe transparencë në zbatimin e Programit.
4. *E drejta e aksesit në të dhëna*. Vlerësohet se Zyrtari ka ushtruar në mënyrë të plotë të drejtën e tij për akses në të gjitha të dhënat e TAP-it, çka ka mundësuar kontroll të efektshëm mbi zbatimin e detyrimeve ligjore dhe programore.
5. *Rekomandime dhe asistencë*. Vlerësohet se janë dhënë rekomandime dhe asistencë profesionale për zbatimin e Programit, duke forcuar funksionet e mbikëqyrjes dhe duke kontribuar në përmirësimin e proceseve të brendshme.
6. *Raportimi i shkëlqesive të mundshme*. Vlerësohet se Zyrtari ka respektuar detyrimin për të raportuar shkëlqesitë potenciale tek autoritetet dhe organet drejtuese të TAP-it, duke siguruar funksionimin e mekanizmave parandalues përdorimin e adresës elektronike të dedikuar regulatorycompliance@tap-ag.com
7. *Informacioni tregtar i ndjeshëm*. Vlerësohet se janë zbatuar rregullat për trajtimin e informacionit të ndjeshëm tregtar, duke shmangur çdo rrezik të shpërndarjes së paautorizuar dhe duke ruajtur integritetin e të dhënave konfidenciale.

8. *Marrëdhënie tregtare dhe financiare.* Vlerësohet se Zyrtari ka dhënë këshilla rregullatore mbi çështje të rëndësishme tregtare dhe financiare, përfshirë testimin e tregut, marrëdhëniet me aksionarët dhe rastet e adresuara pranë Komisionit Evropian.
9. *Bashkëpunimi me Autoritetet.* Vlerësohet se është mbajtur një raportim i rregullt dhe bashkëpunim i plotë me autoritetet rregullatore, në përputhje me Direktivën e Gazit dhe praktikatat e transparencës institucionale.
10. *Pavarësia operationale.* Vlerësohet se TAP ka zbatuar me korrektësi rregullat për pavarësinë operationale si Operator i Pavarur i Sistemit të Transmetimit dhe se Zyrtari ka monitoruar respektimin e tyre në praktikë.
11. *Pavarësia e Bordit dhe punonjësve.* Vlerësohet se janë respektuar kërkesat për pavarësinë e anëtarëve të Bordit dhe punonjësve të TAP-it, duke u siguruar që standardet e integritetit dhe paanshmërisë të jenë të garantuara.
12. *Emërimi dhe rinovimi i organeve drejtuese.* Vlerësohet se procedurat për emërimin, rinovimin dhe përfundimin e mandatit të organeve drejtuese janë kryer në përputhje me Programin e Pajtuashmërisë dhe parimet e qeverisjes së mirë.
13. *Zbatimi i Programit të Pajtuashmërisë.* Vlerësohet se Zyrtari ka zbatuar detyrimet për trajnimin vjetor të punonjësve dhe anëtarëve të Bordit mbi Programin, si pjesë e detyrueshme e prezantimit për punonjësit e rinj dhe anëtarët e rinj të Bordit, me qëllim njohjen dhe zbatimin e duhur të Programit nga të gjithë. Përmirësimi i mekanizmave inovative në kuadër të garantimit me efektivitet të njohjes së programit duke bërë një diferencë me vitet parardhese kete vit pyetesoret mbi njohjen e programit jane implementuar permes sistemit te menaxhimit te burimeve njerezore HRMS.